



Pranuar / Dorezuar Punijeno/Prodato Received/Delivered	27.07.2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ/Jedinica Org./Unit	Nr Prot br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDMSHCK	5380/2023		1/6



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

A.nr.837/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.837/2023 të datës 13.06.2023 të parashtruar nga ankuesja me adresë kundër, përgjigjes së Komisionit të Pranimit në kuadër të Komunes së Drenasit, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 27.07.2023, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.837/2023 e datës 13.06.2023 e parashtruar nga ankuesja
- II. Shfuqizohet Vendimi i datës 30.05.2023 i Komisionit të Pranimit në Komunën e Drenasit.
- III. Anulohet Konkursi me Nr. Reference: RN00011224 i datës 16.03.2023 për emrin e grupit Specialit i Përgjithshëm i Mjedisit pozita "Zyrtar për Menaxhimin e Mbeturinave" të shpallur nga Komuna e Drenasit dhe çdo akt tjetër që rrjedh nga ky proces.
- IV. Obligohet Kryetari i Komunës së Drenasit dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

## Arsyetim

Komuna e Drenasit më datë 16.03.2023 ka shpallur konkursin me Nr. reference: RN00011224 për emrin e grupit Specialit i Përgjithshëm i Mjedisit për pozitën "Zyrtar për Menaxhimin e Mbeturinave", ku afati për aplikim ka qenë nga data 06.04.2023 deri më datë 17.04.2023. Në këtë konkurs kanë aplikuar pesë (5) kandidatë në mesin e tyre edhe ankuesja, ku sipas njoftimit për verifikim paraprak të datës 25.04.2023 këtë verifikim e kanë kaluar vetëm dy (2) kandidatë në mesin e tyre edhe ankuesja e cila i është nënshtruar fazave të procedurës duke përfshirë testin me shkrim, vlerësimin e jetëshkrimit dhe intervistën me gojë. Pas përfundimit të procedurës, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Komunës së Drenasit më datë 25.05.2023 ka publikuar njoftimin e rezultateve përfundimtare të vlerësimit ku ankuesja është renditur e dyta me 75 pikë, dhe në bazë të këtij njoftimi palëve të pakënaqura me këtë vlerësim i është dhënë e drejta për parashtrim të ankuesve brenda 3 ditëve tek Komisioni i Pranimit.

Ankuesja kundër rezultatit përfundimtar përmes SIMBNJ më datë 26.05.2023 ka parashtruar ankesë për Komisionin Vlerësues të Pranimit, ndërsa Kryesuesi i Komisionit të Pranimit më datë 30.05.2023 ka njoftuar përmes emailit ankuesen se e drejta e ankesës ndaj rezultatit përfundimtar parashtrohet brenda afatit prej 3 ditësh përmes sistemit SIMBNJ-së ashti siç e gjeni edhe të bashkangjitur në attach, kurse po më këtë datë Komisioni i Pranimit ka nxjerr Vendim me të cilin ka refuzuar ankesën e parashtruar nga ankuesja.

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Komunës së Drenasit më datë 31.05.2023 ka njoftuar se pas rezultatit të testit me shkrim, jetëshkrimit dhe intervistës si dhe afatit të ankesave tek Komisioni i Pranimit ka publikuar listën përfundimtare të kandidatëve.

Ankuesja kundër përgjigjes së Komisionit Vlerësues të Pranimit, më datë 13.06.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 4718/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 19.06.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Komunën e Drenasit. Ndërsa Këshillit më datë 26.06.2023 ka pranuar përgjigje në ankesë së bashku me provat lidhur me çështjen në procedurë.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave me rastin e shqyrtimit të kësaj ankesë ka administruar këto prova:**Ankesën me numër protokoll 4718/2023 e datës 13.06.2023 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin datës 25.05.2023 dhe 31.05.2023 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore; Emailin e datës 26.05.2023 nga ankuesja lidhur me ankesën dërguar në [simbj@rks-gov.net](mailto:simbj@rks-gov.net) dhe të tjerët; Ankesën e datës 26.05.2023 e parashtruar nga ankuesja tek Komisioni Vlerësues i Pranimit; Emailin e datës 30.05.2023 nga ankuesja për Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 19.06.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 26.06.2023; Konkursin me Nr. reference: RN00011224 për emrin e grupit Specialit i

Përgjithshëm i Mjedisit për pozitën *Zyrtar për Menaxhimin e Mbeturinave*; Vendimin 01Nr.111/01-6826 të datës 14.04.2023 për themelimin e komisionit të pranimit; Akt Emërimin e datës 21.04.2023 për Akt Emërimin e datës 03.06.2012 për ; Akt Emërimin e datës 14.02.2022 për Akt Emërimin e datës 08.06.2012 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Akt Emërimit i datës 04.09.2019 për , Njoftimin e datës 25.04.2023 dhe 0205.2023 nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore për verifikim paraprak; Formularët e vlerësimit të jetëshkrimit për ankuesen dhe kandidaten të datës 22.05.2023; Formularët e vlerësimit të intervistës me gojë për ankuesen dhe kandidaten të datës 24.05.2023; Aplikacionin e ankueses i datës 11.04.2023; Vendimin e datës 30.05.2023 të Komisionit të Pranimit për refuzimin e ankesës së ankueses; Diplomën me Nr. 3547 të ankueses; Vërtetimin ref.Nr.5179 të datës 11.10.2022; Certifikatën maj 2017; Certifikatën 28.01.2016; Referencën me numër 352/IKMN/2022 të datës 27.05.2022; Letër reference na Teatri Oda; Referencën AMMK/IHMK/14.01.2022; Dokument identifikimi i ankueses; Vërtetim i datës 22.08.2022 i lëshuar nga Policia e Kosovës; Certifikatën e datës 17.11.2022 e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë; Aplikacionin e kandidates të datës 13.04.2023; Diplomën me Nr. 2404 të kandidates Certifikatën nga KIESA; Certifikatën shtator 2022; Certifikatën mbi dënimet penale e datës 29.03.2023; Referencën e datës 05.04.2023; Letër Rekomandimin nga Qendra për Edukim dhe Zhvillim Mjedisor; Vërtetimin me Nr.720 i datës 21.05.2021; Dokument identifikimi për kandidaten Certifikatën dhjetor 2021, dhjetor 2020; Certifikatën e datës 03.06.2022; Certifikatën e datës 04.30.2023; Certifikatën për periudhën 26-29.10.2022; Pasqyrën e llogarisë nga Trusti për periudhën 01.08.2022 deri 04.04.2023; Renditjen përfundimtare të kandidateve e datës 24.05.2023.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses, **është e bazuar, sepse:**

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se Komisioni i Pranimit më rastin e përgjigjes nuk ka qenë e argumentuar për shkak se kandidatja fituese nuk posedon diplomë adekuate pasi që nuk plotëson kushtet e konkursit respektivisht atë të përgatitjes profesionale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil si dhe duke u bazuar në nenin 86 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"Organi publik detyrohet, sipas detyrës zyrtare, të shqyrtojë të gjitha faktet dhe të vlerësojë të gjitha rrethanat e nevojshme për zgjidhjen e çështjes administrative"*, do të bëjë shqyrtimin në tersi të procedurës së pranimit për emrin e grupit Specialit i Përgjithshëm i Mjedisit për pozitën *"Zyrtar për Menaxhimin e Mbeturinave"*, të shpallur nga Komuna e Drenasit.

Kolegji i Këshillit nga shkresat e lëndës ka gjetur se në bazë të konkursit me Nr.reference: RN00011224 për emrin e grupit Specialit i Përgjithshëm i Mjedisit për pozitën *Zyrtar për Menaxhimin e Mbeturinave*, të shpallur me datë 16.03.2023 nga Komuna e Drenasit, kërkesa të përgjithshme formale kanë qenë: *"Arsimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare FSHMN: drejtimi Ekologji dhe Mbrojtje e Mjedisit, Kimi teknologjike me të paktën 180*

*kredi/ECTS; Përvoja e punës e kërkuar: Së paku 1 (një) vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedua për plotësimin e pozitës së lirë të punës”.*

Sa i përket mënyrës së shpalljes së konkursit konkretisht kërkesave të përgjithshme formale, Kolegji i Këshillit, konstaton se sipas Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë është bërë kategorizimi i pozitave në shërbimin civil siç parashihet me nenin 33 paragrafi 2, i cili përcakton se: “2. Pozitat në Shërbimin Civil ndahen në këto kategori: 2.1. *Kategoria e lartë drejtuese, që përfshin këto pozita: sekretar i përgjithshëm, drejtor ekzekutiv dhe zëvendësdrejtor i një agjencie ekzekutive, si dhe pozitat e barasvlershme;* 2.2. *Kategoria e mesme drejtuese, që përfshin këto pozita: drejtor i departamentit dhe pozitat e barasvlershme me të;* 2.3. *Kategoria e ulët drejtuese, që përfshin këto pozita: shefi i divizionit dhe pozitat e barasvlershme me të;* dhe 2.4. *Kategoria profesionale, që përfshin zyrtarët profesionalë”,* atëherë Kolegji i Këshillit, në vështrim të nenit 13 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil ndërlidhur me pozitat e kategorisë profesionale është përcaktuar se: “1. *Klasat përbërëse të kategorisë profesionale dhe emërtesat e lejuara për secilën klasë janë: Profesional 1 Profesional 2 Profesional 3”,* rrjedhimisht meqenëse pozita e shpallur nga Komuna e Drenasit është e kategorisë profesionale klasa profesionale 2, atëherë sipas shtojcës Nr. 1/7 lidhur me përshkrimin e përgjithshëm të punës për klasën Profesional 3, konkretisht kërkesat e përgjithshme formale janë përcaktuar: *a) Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve. Diplomë e nivelit të pestë të KKK, për profesione deficitare (TIK)”,* si rrjedhojë Komuna e Drenasit me rastin e shpalljes së këtij konkursi respektivisht përcaktimit të kredive të diplomave (180 kredi/ECTS) nuk i është referuar rregullores përkatëse por ka dalur përtej këtij përcaktimi.

Po ashtu nëse i referohemi Shtojcës me Nr. 2 lidhur me grupet tip të administrimit të përgjithshëm dhe posaçëm për grupin Specialist i përgjithshëm i mjedisit tek fusha e kërkuar e arsimit është përcaktuar: *Inxhinieri Mjedis/ Mjedis/ Kini e Përgjithshme, Ekologji dhe të ngjashme,* kështu që edhe në këtë aspekt nuk janë përfillur kriteret e kësaj rregulloreje për grupin përkatës të pozitave, ndërsa duke marr për bazë kërkesa të përgjithshme formale të konkursit me Nr. reference: RN00011224 për emrin e grupit Specialist i Përgjithshëm i Mjedisit për pozitën “*Zyrtar për Menaxhimin e Mbeturinave*”, të shpallur nga Komuna e Drenasit kërkesat për arsimimin e kërkuar janë kufizuar vetëm në ato diploma të fituara në Fakultetin e Shkencave Matematikore-Natyrore, ndërsa me mos respektimin e kriterëve sipas rregullores së lartcekur, u është mohuar e drejta për aplikim kandidatëve që kanë diploma të tjera jashtë Fakultetit të Shkencave Matematikore-Natyrore e të cilat do të ishin adekuate sipas kërkesave në shtojcën me Nr. 2 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Bazuar në vetë kërkesat e përgjithshme formale të konkursit me Nr. reference: RN00011224 për emrin e grupit Specialist i Përgjithshëm i Mjedisit për pozitën “*Zyrtar për Menaxhimin e Mbeturinave*”, të shpallur nga Komuna e Drenasit, rezulton se në këtë konkurs nuk është kërkuar ndonjë përgatitje tjetër profesionale apo e ngjashme në raport me ato që janë kërkuar, nga rrjedhë se sipas provave të lëndës, kandidatja fituese posedon Diplomë me Nr. 2404 të lëshuar nga Fakulteti i Ndërtimtarisë i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” me të cilën dëshmohet se e njëjta ka mbaruar studimet themelore në këtë fakultet respektivisht në Departamentin e Inxhinierisë së Mjedisit-Programi Inxhinieri e Ambientit duke marr titullin

Bachelor i Ndërtimtarisë, si rrjedhojë kjo diplomë nuk hyn në kuadër të kufizimeve sipas konkursit të lartcekur konkretisht në kuadër të Fakultetit të Shkencave Matematikore-Natyrore.

Gjatë shqyrtimit të procedurave të tjera që ndërlidhen me këtë konkurs, Kolegji i Këshillit, në bazë të dokumentacionit të ofruar nga Komuna e Drenasit, rezulton se ankuesja sa i përket përvojës së punës posedon Referencën me numër 352/IKMN/2022 të lëshuar nga Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit me të cilën dëshmohet se ka përfunduar praktikën për periudhën 14.03.2022 deri më datë 20.04.2022, sipas Referencës AMMK/IHMK/14.01.2022 të lëshuar nga Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit po ashtu ka kryer praktikën nga data 13.12.2021, deri më datë 14.01.2022, sipas letër referencës të lëshuar nga Teatri Oda nuk evidentohet saktë periudha e punës dhe nuk evidentohet saktë se cila është puna e ankueses në këtë institucion, me ç' rast Kolegji i Këshillit, konstaton se në bazë të këtij dokumentacioni rrjedhë se ankuesja nuk ka plotësuar kërkesat e përgjithshme formale të konkursit që ndërlidhen me përvojën e punës, ngase nuk është argumentuar me prova materiale se e njëjta plotëson këtë kërkesë, ndërsa nga Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Drenasit është vlerësuar se plotëson këtë kërkesë të konkursit dhe është përfshirë në fazat e tjera, për me tepër edhe Komisioni i Pranimit tek vlerësimi i jetëshkrimit respektivisht tek përvoja e punës ankuesen e ka vlerësuar me maksimumin e pikëve respektivisht shtatë (7) pikë. Bazuar në këtë konstatim rrjedhë se Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Drenasit me rastin e përfshirjes në listën e ngushtë të ankueses ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e përgjithshëm formale të konkursit, duke shkelur dispozitat ligjore në fuqi, kështu që verifikimi paraprak është bërë në kundërshtim me nenin 34 paragrafi 6 nën paragrafi 6.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 15 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ndërsa Komisioni i Pranimit me rastin e vlerësimit të jetëshkrimit që ndërlidhet me përvojën e punës, ka vepruar në kundërshtim me nenin 34 paragrafi 6 nën paragrafi 6.2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 16, nenin 22 paragrafi 3, paragrafi 4 nën paragrafi 4.2 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Lidhur me parashtrimin e ankesës ndaj vlerësimit përfundimtar, Kolegji i Këshillit, konstaton se Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Komunës së Drenasit më datë 25.05.2023 ka publikuar njoftimin e rezultateve përfundimtare të vlerësimit dhe në bazë të këtij njoftimi palëve të pakënaqura me këtë vlerësim i është dhënë e drejta për parashtrim të ankesës brenda 3 ditëve tek Komisioni i Pranimit, kështu që ankuesja ndërlidhur me këtë brenda afateve të përcaktuara me nenin 25 paragrafi 5 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ka parashtruar ankesë, ngase të njëjtën e ka parashtruar më datë 26.05.2023 duke e dërguar në [simbj@rks-gov.net](mailto:simbj@rks-gov.net), kështu që edhe nëse e njëjta nuk ishte dërguar në këtë adresë, por ishte dërguar edhe fizikisht në Njësinë e Burimeve Njerëzore do të ishte e ligjshme, ngase Rregullorja (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës në asnjë dispozitë të saj nuk ka përcaktuar që ankesa ndaj fazave të procesit duhet të bëhet vetëm përmes sistemit HIRMS, sepse sipas Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, respektivisht sipas nenit 77, është përcaktuar se: *"Dispozitat e këtij Ligji mbi formën, përmbajtjen dhe parashtrimin e kërkesës fillestare, do të zbatohen, përshtatshmërisht, për çdo aplikim, peticion, propozim, ankesë,*

kundërshtim, deklaratë apo çdo lloj tjetër parashtrere, që palët i drejtojnë një organi publik”, rrjedhimisht çdo dispozitë lidhur me parashtrimin e kërkesës vlen edhe për rastet e parashtrimin të ankesës, ndërsa ky ligj lejon që kërkesat/ankesat mund të parashtrihen në formë fizike përmes postës apo edhe në formë elektronike siç parashihet me nenin 33 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që ankesa e datës 26.05.2023 është e afatshme ndërsa që Vendimi i datës 30.05.2023 i Komisionit të pranimit në Komunën e Drenasit është i paligjshëm për shkak që nuk konstaton gjendjen faktike po ashtu nuk ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses në pajtim me nenin 48 ndërlidhur me nenin 134 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, andaj si i tillë është në kundërshtim me nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, 1.5 dhe 1.6 të këtij ligji.

Prandaj nga ajo që u tha si më lartë, Kolegji i Këshillit ka ardhur në konstatimin se procedura e pranimit sipas konkursit me Nr. Reference: RN00011224 të datës 16.03.2023 për emrin e grupit Specialit i Përgjithshëm i Mjedisit pozita “Zyrtar për Menaxhimin e Mbeturinae” të shpallur nga Komuna e Drenasit, është zhvilluar në kundërshtim me parimin e pranimit të zyrtarëve publikë të përcaktuar me nenin 6 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 4 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, kështu që shkeljet e evidentuara si më lartë e bëjnë të pavlefshme këtë procedurë, si rrjedhojë sipas Kolegjit të Këshillit, konstaton se Kryetari i Komunës së Drenasit dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore janë të obliguar që të ndërmarrin të gjitha veprimet për zbatimin e këtij vendimi si në dispozitiv.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**

Lënda, A.nr.837/2023, datë 27/07/2023

**Avdyl BEKTESHI**

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Arben MEHMETI**

Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses,
- Kryetarit të Komunës së Drenasit;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Drenasit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së;